



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 809 Prot.

Tiranë, më datë 08.062021

VENDIM
Nr. 280, datë 08.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.06.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Përmirësimi i infrastrukturës turistike në zonën e “Zvërnec-Nartë” dhe “Ujërave termale të Bënjës”, me aplikues FSHZH dhe zhvillues “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
 2. Të hiqen Totemet e propozuara në projekt, për zonën “Zvërnec-Nartë” dhe “Ujërave termale të Bënjës”, si zëvendësimin e tyre me Tabelat Informuese sipas variantit Nr. 2 të propozuar nga projektuesi;
 3. Parkimi i propozuar në zonën “Zvërnec-Nartë” të realizohet sipas variantit të propozuar nga projektuesi duke evituar gërmimin e shtresave të dheut;
 4. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 5. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Përmirësimi i infrastrukturës turistike në zonën e “Zvërnec-Nartë” dhe “Ujërave termale të Bënjës”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 6. Në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 72, punimet të mbikëqyren nga subjekte të licencuara për këtë qëllim ose institucione të shterërore të specializuara të trashëgimisë kulturore;
 7. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 9. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

